



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRY SHE

23 maj 2016, Prizren

THIRRJE PËR OFERTË

Realizimi i video klipit për informim të publikut të gjerë mbi çështjet e qasjes së Personave me Nevoja të Veqanta

Realizimi i video klipit është aktivitet në kuadër të projektit “Prizreni, një qytet pa pengesa” i cili përkrahet financiarisht nga USAID nga programi E4E, dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK. Qëllimi i përgjithshëm i projektit përfshinë ngritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara dhe të rinjve në projektimin e Prizrenit pa pengesa.

EC Ma Ndryshe fton kompanitë/konsorciumet e përzgjedhura të dorëzojnë ofertat e tyre për realizimin e video klipit. Kompanitë/konsorciumet e interesuara për ofertim duhet të përgatisin projektin ideor (konceptin regjisorial, sinopsisin, orarin e realizimit) së bashku me paralogari, përshkrim teknik dhe ofertën financiare.

Kompanitë e interesuara duhet të jenë profesionale në lëmin e prodhimit të filmike dhe të kenë përvojë në realizimin e video klipeve dhe dokumentarëve. Ofertat duhet të dorëzohen në 1 origjinal dhe 2 kopje të mbyllura në zarf së bashku me ofertën financiare.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përmbajë edhe: certifikatën e regjistrimit të kompanisë, dhe dokumente të tjera që dëshmojnë kompetencën profesionale të kompanisë.

Ofertat duhet të dorëzohen në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Saraçët Nr. 5, Prizren, jo më vonë se më 07.06.2016 deri në ora 16:00.

Për më shumë informata kontaktoni info@ecmandryshe.org dhe 029 222 771